

VENDIM
Nr.671, datë 27.9.2006

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE,
JOPUBLIKE “JUSTICIA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 12 e 13 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e lejes për hapjen e shkollës së lartë univesitare, jopublike “Justicia”, në emër të shoqërisë “Justicia”, sh.p.k. e cila do ta ushtrojë këtë veprimtari në qytetin e Tiranës.

2. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Justicia” do të jetë e nivelit universitar, me degën e vetme “Drejtësi”.

3. Shkolla e lartë universitare, jopublike, “Justicia” do të ofrojë studime në ciklin e parë të studimeve universitare, të cilat do të zgjasin 4 (katër) vite akademike. Në mbarim të studimeve ky universitet do të japë diplomë universitare “Bachelor” me titullin “Jurist”.

4. Shkolla e lartë universitare, jopublike “Justicia” do të fillojë veprimtarinë në vitin akademik 2006-2007 dhe do të ketë sistemin e studimeve me kohë të plotë.

5. Ministria e Arsimit dhe Shkencës të bëjë verifikimin e plotësimit të kushteve për fillimin e procesit mësimor. Ndryshimet në adresë, stafin pedagogjik, planet dhe programet, si dhe në elementet e tjera, të miratuara, të bëhen me miratimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kryerjen e procesit të vlerësimit dhe të akreditimit të kurseve të studimit, si dhe për zbatimin e ligjshmërisë në institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha